



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 11716/24
Kaçanik, 28.05.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja V (pestë) e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 28 Maj 2024 (E Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arben Thaqi- OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë znj. Hafize Sallahu – Drejtoreshë DKRS .

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Proceszmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z. Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e V-të (pestë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 28 Maj, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ? Procesverbalin e mbledhjes së IV (katërt) të Komitetit për Komunitete i vitit 2024, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IV (katërt) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024, të datës 23.04.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-9376/24.

2. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ;

znj. Hafize Sallahu : Si zakonisht edhe këtë vit kemi filluar me subvencionimin e OJQ-ve që veprojnë në komunën Kaçanikut.

Në vitin 2022, Komuna e Kaçanikut ka ndarë subvencione për organizatat joqeveritare (OJQ) që veprojnë në këtë komunë. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përgjegjësinë për këtë proces. Ndarja e subvencioneve është bërë me qëllim të përmirësimit të buxhetit dhe për të mbështetur aktivitetet e OJQ-ve. Ky proces zhvillohet vit pas viti dhe ne me një thirrje i kemi subvencionua të gjitha OJQ-të, me një shumë prej 70.000.00 €, në vitin e dytë 2023 i kemi publikuar dy thirrje për shkak të rrethanave të tilla dhe nuk kemi dashur që ndonjë OJQ të mbetet pa u subvencionua sepse këto para ndahen për ta, shuma e ndarjeve të mjeteve ka qenë e njëjtë me vitin 2022, ndërsa për vitin 2024 subvencionet kanë pësua një ngritje nga 70.000.00€ kanë kalua në 85.000.00 €, që mund themi se ka qenë një ngritje tjetër sepse sipas kërkesave të cilat kanë dalë në debate publike që i kemi mbajtur me OJQ-të në vitin 2022 kanë qenë kërkesë e veçantë e OJQ-ve blerja e një minibusi vlere e tij cilit ka qenë 30.000.00€.

Minibusi është në palestrën sportive dhe është në funksion mirëpo jemi në mungesë të një shoferi por megjithatë jemi duke gjetur mënyrën veç ka filluar sipas kërkesave të OJQ-ve është në lëvizje edhe minibusi. Për këtë vit ka qenë thirrja publike e shpallur në faqen zyrtare të komunës së Kaçanikut por që fatkeqësisht disa organizata joqeveritare nuk e kanë vërejtur apo nuk qenë gati andaj në këtë vit jemi detyruar me i publiku dy thirrje publike për shkak që në thirrjen e parë nuk kanë aplikuar të gjitha organizatat joqeveritare që ligjërisht kemi mundur mos me realizua thirrjen e dytë por ne jemi idhtarë për me i subvencionua organizatat joqeveritare sepse këto organizata bashkëpunojnë ngushtë me komunën e Kaçanikut dhe me Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport. Sot unë i kam vetëm të dhënat e thirrjes së parë publike dhe vlerën e mjeteve që janë ndarë ndërsa te thirrja e dytë e kam publikimin e thirrjes mirëpo rezultatet besoj që ende nuk janë publikuar sepse sot ka përfunduar komisioni punën dhe nuk jam në dijeni a janë shpallur në faqen zyrtare të komunës së Kaçanikut.

Shpresoje që në vitin e ardhshëm do të mbaj prapë një debat publik dhe do ju beje thirrje organizatave joqeveritare që të aplikojnë në thirrjen e parë me qëllim që te mos dëmtohet procesi i punës së drejtorisë së kulturës por edhe mos te dëmtohet as buxheti sepse komisioni është me pagesë dhe çdo thirrje që e realizon komisioni duhet të punoj katër apo pesë ditë që të beje verifikimin e dokumentacionit të ndarjeve të subvencioneve për atë arsye kam informata që komisioni ka përfundua sot punë por nuk e kam rezultatin e thirrjes dytë ndërsa thirrjes së parë e kam rezultatin, këtu ju jeni të informuar edhe në vitet e tjera që kam deklaruar se sa organizata janë. Këtë Vendim që kam para vete thotë lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në fushën e kulturës, rinisi dhe sportit në shumën prej 67,450.00 euro për vitin 2024 do të thotë është për thirrjen e parë.

KULTURË

Organizimi i Festivalit Kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Kulturo – Artistike
Qendra Kulturore "Kaçaniku" 7.000.00 € .

Organizimi i Festivalit të Këngës Popullore për Fëmijë "Kaçaniku Këndon".

Shoqëria Kulturo Artistike Gryka e Kaçanikut 5,000.00 € .

Organizimi i aktivitetit për mërgimtarët, me moton " Ju jeni pjesë e atdheut"

Shoqëria Kulturore Artistike Tingujt e Vendlindjes 2,000.00 € .

Subvencionim/aktivitetet sipas planprogramit te OJQ- ve

Qendra Kulturore "Kaçaniku" 2,000.00 € , Shoqëria Kulturore Artistike Tingujt e Vendlindjes 3,500.00 € , Shoqëria Kulturo Artistike Gryka e Kaçanikut 2,000.00 € , Shoqata Kulla e Gurit 1,500 €.

RINI DHE SPORT

Klubi i Futbollit të Femrave Bazeli 2015 Biçec - Kaçanik 4,000.00 € , Klubi i Futbollit Lepenci Kaçanik 17,700.00 € , Klubi Basketbollistik Kaçaniku-Meshkujt 4,000.00 € , Klubi Volejbollit për Femra Kaçaniku 4,000.00 € , Klubi i Mundjes Kaçaniku 3,500.00 € , Klubi Volejbollit Kaçaniku Meshkujt 2,900.00 € , Klubi Basketbollistik Lepenci 1,800.00 € , Shoqata e Peshkatarëve Sportiv dhe Rekreativ Trofta e Lepencit 1,000.00 , Kampi i Artistëve Mural 2,150.00 , Fondacioni Bonevet Kaçanik 1,400.00 , Këshilli i Veprimt Rinor Lokal-Kaçanik 2,000.00 € .

znj.Arta Avdiu : Kriteret a vendosen nga qeveria apo nga komuna ?

znj. Hafize Sallahu : Kriteret vendosen nga Drejtoria Kulturës, Rinis dhe Sportit. Tek thirrja e dytë theksoj që shuma e ndarë është në vlerë prej 16.550.00 €. në rini dhe sport janë të paraparë shuma prej 15.550.00 euro dhe Kulturë vlera prej 1,000.00 € .

znj.Arta Avdiu : Shqetësuese qenka pse janë shpallur dy herë thirrjet, a ka dal publikimi me afat, për çka ju ka ikur kjo thirrje për të aplikuar.

znj. Hafize Sallahu : Thirrja publike është publikuar me afat në faqen zyrtare të komunës dhe për këtë thirrje nuk ka përgjegjësi (faj) as komuna Kaçanikut dhe as Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport por përgjegjësia është te qytetaret qe nuk e përcjellin faqen zyrtare të komunës, sepse një muaj ka qenë thirrja.

z.Arben Thaqi : E përgëzoj drejtoreshën për punën dhe njëherit ndarjen e subvencioneve e shoh si interes i OJQ-ve dhe është ndarje qe ju ka dhënë mundësi edhe atyre qe kanë ngec për afatet kohore pra kjo është mundësi shtesë qe jua ka dhënë, këtë veprim qe ka bërë drejtoresha duhet me qenë falënderues edhe organizatat për këtë mundësi qe ju ka dhënë pasi qe ka pasur për qellim që të gjitha organizatat me i subvencionua dhe mos me mbetë asnjë pa u subvencionua.

z.Betim Shala : Te çështja e stadiumit, a është shkëputur kontrata me qellim qe të krijohet mundësia për një kontrate të re apo ende nuk është shkëputur?

znj. Hafize Sallahu : Në momentin kur kam ardhur në pozitën e drejtoreshës, hapi i parë që kam ndërmarrë ka qenë çështja e stadiumit të futbollit, pastaj mbas gjashtë muajve kam bërë një takim me ministrin e kulturës këtu në Kaçanik, i cili na premtoi se projekti i parë u ndal njëherë për shkak pandemisë por mbas pandemisë kostoja e çmimeve u rrit dhe punëkryesi ka kërkuar shtesë por këtu nuk mundem me fajësua ministrin sepse ai na i ka hapur të gjitha rrugët sa i përket ministrisë por punëkryesi nuk ka shkuar me i rregullua letrat për 20%, me njëfarë fjalë nuk ka pas interes me vazhdua më, por për shkëputjen e kontratës zyra e prokurimit këtu e ka zvarritur këtë proces sepse nuk vinte kompania me bë ndërprerjen e punimeve, njëherë ka qene dashur të bëhet ndërprerja e punimeve e pastaj me ju shkëput kontrata. Që dy muaj është shkëputur kontrata dhe unë ja kom paraqitur ministrin të kulturës me dokumentacion dhe me kopje fizike por edhe

përmes emali adresës, sepse shkresa e fundit e ardhur nga ministri është kështu “shkëputë kontratën pastaj sjelle projektin e ri”, për informim është duke u bërë projekt i ri pastaj ta shohim reflektimin e ministrisë.

znj.Arta Avdiu : Po e shoh në këtë listë Shoqata e Peshkatarëve Sportiv dhe Rekreativ Trofta e Lepencit e kanë ndarë një shumë prej 1,000.00 euro, çfarë kriterë jeni bazua që e keni ndarë këtë shumë, vetem aktivitetet i keni marrë për bazë apo çfarë kriterë? Pse nuk e dënoni Klubin e futbollit “Lepenci” sepse shumë më të madhe ju e keni ndarë dhe nuk ka dhënë asnjë rezultat, unë e kuptoj që ka nevojë shumë Lepenci dhe mendoj që ndëshkimi kishte me ndikua në rritjen e suksesit të klubi Lepenci.

znj. Hafize Sallahu : Të gjitha organizatat joqeveritare që veprojnë në komunën e Kaçanikut thash edhe në fillim kanë bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, pastaj për çdo thirrje që publikohet për ndarje të subvencioneve formohet një komision i cili e verifikon aplikimin e asaj organizate se për çfarë ka aplikua për me jua ndarë mjetet, pastaj pas aplikimit dhe pas përfitimit të mjeteve të organizatave që e fiton subvencionin formohet komisioni tjetër për monitorim. Ju them me shumë sinqeritet që të peshkatarët në vitin e kaluar e kanë pasur të njëjtën shumë por raportimin dhe kanë raportuar vetëm për 800.00 € dhe 200.00 € tjera nuk e dimë as na ku i kanë shpenzuar sepse raportimi është bërë për 800.00 € që realisht është dashtë me i diskualifikua, edhe më vonë kanë sjelle një faturë me pretekstin që e kanë harruar me shti tek raportimi, por ne nuk e dimë çfarë aktivitete zhvillojnë sepse nuk bashkëpunojnë me Drejtorin për Kulturë. E kam parë një postim të tyre që kanë bërë një aktivitet me kryesueset të qeveris dhe të VV-së dega Kaçanik.

Sa i për këtë Lepencit, me këto mjete të cilët i kemi ndarë as për një sezon nuk i dalin futbollit. Unë nuk po premtoj por po shpresoj në rritjen e subvencioneve po shpresoj edhe në mjete për bursa për sportistët dhe artistët të dalluar të vitit dhe sipas gjitha gjasave mendoj se do arrij këtë është njëjtë sikur studentët që aplikojnë për bursa, kanë me aplikuar edhe sportistët për bursa.

znj.Arta Avdiu : Në rast se nuk i raportojnë këto të dhëna çfarë ndodh?

znj. Hafize Sallahu : Në rast se nuk i raportojnë të dhënat diskualifikohen.

z.Betim Shala : Drejtoresh a ju ka thirrur Drejtoria e Urbanizimit gjatë hartimit të planit zhvillimor komunal, për shembull me i caktua lokacionet të rruga Mejdi Dalloshi , rruga Skënderbeu me u bërë ndonjë fushë e futbollit.

znj. Hafize Sallahu : Unë jo, por ka qenë një ankese e zyrtarit tim për sport z.Fatos Vishi dhe i ka takuar zyrtarit sportit me marr pjesë gjatë hartimit të planit zhvillimor.

z.Ekrem Livoreka : A ka pasur ndonjë OJQ apo klub që ka aplikuar për herë të parë dhe sa janë të kënaqura OJQ-të , për ndarjen e subvencioneve dhe a ka pasur najë ankesë?

znj. Hafize Sallahu: Me thënë që vijnë e thonë faleminderit apo jam ndarë i kënaqur ky term nuk ekziston, por ka edhe që thonë ka qenë mirë por ka mund me qenë edhe më mirë, po bëjnë edhe ankesa por është komisioni që merret me këtë çështje. Unë nuk e mohoj që ka organizata që meritojnë më shumë por që mjetet nuk mjaftojnë . Të vetmit

organizata qe nuk aplikojnë janë shkollat e futbollit , respekt shumë për ta qe nuk kanë insistua sepse me pas aplikuar kemi te drejte me i subvencionua.

znj.Arta Avdiu : Në fund dua të falënderoj drejtoreshën qe ka qenë këtu prezent dhe e përgëzoj qe ke bërë një punë të mrekullueshme

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 14:18.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**

